



# Zhvillimi i Sistemeve të Qëndrueshme Ushqimore në Shqipëri

## Eventi i Hapjes dhe Dialogu i Parë në Seri

### *Koncepti dhe Agjenda*

**të Martën, 1 nëntor në orën 09:30-11:30 CET**

*(Informacioni mbi vendin dhe lidhjen online do të ndahen së shpejti)*

### **Sfondi**

Dialogu Kombëtar për Sistemet e Qëndrueshme Ushqimore (SFS) në Shqipëri, në përgatitjen e Samitit të OKB-së për Sistemet Ushqimore 2021, u organizua në qershor dhe korrik 2021 dhe u udhëhoq nga Qeveria e Shqipërisë (Takuesi Kombëtar: Zëvendësministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural) dhe me mbështetje nga OKB-ja. Gjatë Samitit të OKB-së, Shqipëria shpalli *National Pathways* (shtigjet kombetare) për zhvillimin e SFS dhe Shkëlqesia e saj, Frida Krifca, Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e Republikës së Shqipërisë deklaroi synimet dhe prioritetet e vendit për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm të sistemeve ushqimore.

Tani është koha për t'u angazhuar më tej me politikë-bërësit sektorial përkatës (p.sh. bujqësia, turizmi, shëndetësia, arsimi, tregtia, etj.), komunitetet lokale dhe bashkitë (p.sh. grupet e fermerëve, bizneset bujqësore të vogla/të mesme lokale, një agjenci lokale këshillimore për ekstensione, shërbimi, etj.). Për të lehtësuar integrimin e mëtejshëm, forcimin dhe shkallëzimin e qasjes së kombinuar SFS, FAO do të ofrojë mbështetje për dialogjet në nivel kombëtar dhe lokal që do të kryhen në kuadrin e Platformës SFS-MED - Një iniciativë me shumë palë për Sistemet e Qëndrueshme Ushqimore në Mesdhe. Mediterranean<sup>1</sup>.

### **Objektiva**

Eventi mirëpret palët e interesuara për të nisur zbatimin e projektit në nivel vendor në kuadrin e Platformës SFS-MED - Një iniciativë me shumë palë për SFS në Mesdhe. Gjatë eventit, do të komunikohet *National Pathway* (shtegu kombetare) dhe pjesëmarrësit do të inkurajohen të diskutojnë nevojat e përpunimit dhe modifikimit të këtij *shtegu* në lidhje me prioritetet dhe nevojat e vendit, që janë shfaqur që nga përfundimi i Dialogut Kombëtar vitin e kaluar.

Sesionet e diskutimit do të jenë dy pjesë - Së pari, sfidat dhe qëllimet e përbashkëta për të arritur SFS në Shqipëri nga këndvështrimi i ekspertëve/këshilltarëve nga ministri të ndryshme, institucione kombëtare dhe vendore dhe së dyti, nga këndvështrimi i sektorit privat, fermerëve dhe komunitetit rural.

<sup>1</sup> Për më shumë informacion: Transformimi i sistemeve ushqimore – proceset dhe rrugët në Mesdhe: Një ushtrim i inventarizimit (përfshirë Kutinë 1 – Pasqyrë e rrugës kombëtare të Shqipërisë) <https://www.fao.org/documents/card/en/c/cb7978en>.  
Platforma SFS-MED: Sistemet e Qëndrueshme të Ushqimit në Mesdhe <https://www.youtube.com/watch?v=1qgK5tOjRz4>



Food and Agriculture Organization  
of the United Nations



One planet  
eat with care

Sustainable  
Food Systems



Cooperazione Italiana  
allo Sviluppo  
Ministero degli Affari Esteri  
e della Cooperazione Internazionale

Dialogu do të trajtojë gjithashtu agroturizmin si një nga sektorët më të rëndësishëm që kontribuon shumë në ekonominë e vendit dhe ka potencial të lartë për të nxitur zhvillimin e SFS-së si dhe ekonominë e gjelbër të Shqipërisë.



## Programi i ditës

Eventi i Hapjes	
09:00-09:30	Regjistrimi
09:30-09:35	<b>Hapja</b> Prezantimi i kuadrit të projektit dhe platformës SFS-MED Valbona Ylli, Moderatore
09:35-10:00	<b>Fjalë përshëndetëse</b> Frida Krifca, Ministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural  Raimund Jehle, Përfaqësues i FAO  Fiona McCluney, UNRC, Shqipëri
Dialogu i Sistemeve Ushqimore	
10:00-10:15 (10mins)	<b>Prezantimi</b> Statusi i politikës dhe strategjisë aktuale pas Samitit të OKB-së për Sistemet Ushqimore në 2021 Valbona Paluka, Diskutimi (1) Moderatore
(5mins)	Ndikimet e konfliktit në Ukrainë në sektorin bujqësor shqiptar Orjon Xhoxhi, Ekspert i FAO
10:15-10:50 (20mins)	<b>Diskutim (1)</b> Sfidat dhe synimet e përbashkëta për të arritur SFS në Shqipëri <i>- nga këndvështrimi i ekspertëve/këshilltarëve nga ministri të ndryshme, institucione kombëtare dhe vendore</i>  Valbona Paluka, Moderatore
(15mins)	Q&A
10:50-11:25 (20mins)	<b>Diskutim (2)</b> Statusi i praktikave/bizneseve aktuale, sfidat dhe synimet për të arritur SFS në Shqipëri <i>- nga perspektiva e sektorit privat, fermerëve dhe komunitetit rural</i>  Valbona Ylli, Moderator
(15mins)	Q&A
11:25-11:30	Fjala përmbyllëse Valbona Ylli, Moderatore



11:30-	Pije freskuese pas eventit